



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**GJYKATA KUSHTETUESE**

---

*STATISTIKA PËR VEPRIMTARINË  
GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE*

---

---

*PËR VITIN 2024*

---


## KËRKESAT DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE GJATË VITIT 2024

Gjatë vitit 2024 Gjykata Kushtetuese ka pasur **520 kërkesa**, nga të cilat 427 kërkesa janë paraqitur dhe regjistruar gjatë vitit 2024, si dhe 93 kërkesa janë mbartur nga viti 2023.

### KOHËZGJATJA

- ❖ Gjykata ka respektuar të gjitha afatet procedurale të kërkesave, në përputhje me parashikimet e ligjit organik të Gjykatës, si dhe me Rregulloren për Procedurat Gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese.
- ❖ Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatë për vendimet përfundimtare është 8 muaj dhe për vendimet e moskalimit 3 muaj.
- ❖ Aktualisht Gjykata Kushtetuese nuk ka në shqyrtim asnjë çështje të prapambetur.
- ❖ Vlen të theksohet fakti që në Gjykatë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese.

- ❖ Tabelë krahasimore 2021-2024, në lidhje me kërkesat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese, si dhe vendimmarrjet e saj.



## ❖ Vendimet e marra nga Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2024.

Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2024 ka dhënë në total **408 vendime**, 86 vendime përfundimtare dhe 322 vendime moskalimi, si dhe ka në shqyrtim ende pa vendimmarrje 104 çështje<sup>1</sup>.



- ❖ Theksojmë se të gjitha vendimet përfundimtare dhe vendimet e moskalimit janë publikuar dhe zbardhur brenda afateve ligjore.
- ❖ Të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të arsyetuara përfshirë edhe vendimet e moskalimit, të cilat janë të arsyetuara për kriteret e pranueshmërisë.


Më poshtë paraqesim të dhëna statistikore për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2024, të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, si dhe objektit të kërkesës:

### ❖ Kërkesat e grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:

- ✚ 6 kërkesa janë paraqitur nga një grup deputetësh;
- ✚ 3 kërkesa janë paraqitur nga gjykatat, kontroll incidental;
- ✚ 4 kërkesa janë paraqitur nga partitë politike;

<sup>1</sup> Numri total i vendimeve dhe çështjeve në shqyrtim nuk korrespondon me numrin total të kërkesave për shkak të kërkesave të bashkuara (12 kërkesa në 4).

- ✚ 1 kërkesë është paraqitur nga Këshilli i Ministrave;
- ✚ 2 kërkesa janë paraqitur nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 12 kërkesa janë paraqitur nga organizatat;
- ✚ 399 kërkesa janë paraqitur nga individët.



#### ❖ Kërkesat e grupuara sipas objektit:

- ✚ 30 kërkesa janë me objekt *papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*;
- ✚ 1 kërkesë është me objekt *zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Shqipërisë*;
- ✚ 3 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave*;
- ✚ 4 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e akteve të pushtetit publik*;
- ✚ 2 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*;
- ✚ 318 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm*;

- ✚ 16 kërkesa janë me objekt *konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 37 kërkesa janë me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, së bashku me konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 2 kërkesa janë me objekt *deklarimin e mbarimit të mandati të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese*;
- ✚ 14 kërkesa janë me objekt *interpretimin/korrigjimin/rishikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*.




## VENDIMET E MARRA NGA GJYKATA KUSHTETUESE GJATË VITIT 2024

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike 86 vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, sipas dispozitivit të vendimit, si dhe sipas mënyrës së votimit.

❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2024 të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


- ✚ 7 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga një grup deputetësh;
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga gjykatat e sistemit të zakonshëm (kontroll incidental);
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga partitë politike;
- ✚ 5 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga organizatat;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 70 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët.

### Vendimet përfundimtare të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese



❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2024, të grupuara sipas objektit të kërkesës:

- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt *papajtueshmërinë e marrëveshjes ndërkombëtare me Kushtetutën*;
- ✚ 12 vendime u përkasin kërkesave me objekt *papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *mosmarrëveshje kompetencash dhe vendime të Kuvendit të Shqipërisë*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *shfuqizimin e vendimeve gjyqësore së bashku me papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese*;
- ✚ 54 vendime u përkasin kërkesave me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor*;
- ✚ 12 vendime u përkasin kërkesave me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të sistemit të zakonshëm në kuadër të procesit të rregullt së bashku me konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës me objekt *korrigjim vendimi të Gjykatës Kushtetuese*.




❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2024 të grupuara sipas dispozitivit të vendimit:

- ✚ Për 34 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e kërkesës*;
- ✚ Për 21 vendime Gjykata ka vendosur *pranimin e pjesëshëm*;
- ✚ Për 31 vendime Gjykata ka vendosur *rrëzimin e kërkesës*.



❖ Vendimet përfundimtare të marra gjatë vitit 2024 të grupuara sipas mënyrës së votimit:

- ✚ 42 vendime janë *njësëri*;
- ✚ 42 vendime janë me *shumicë votash*;
- ✚ 2 vendime janë *pa kuorum*;






Gjatë vitit 2024 nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe kolegjet e Gjykatës Kushtetuese janë marrë 322 vendime moskalimi.

Më poshtë paraqesim në mënyrë grafike vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, objektit të kërkesës, si dhe kolegjeve/Mbledhjes së Gjyqtarëve.

❖ Vendimet e moskalimit të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese:


- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (kontroll incidental);
- ✚ 3 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga shoqatat;
- ✚ 316 vendime u përkasin kërkesave të paraqitura nga individët;
- ✚ 1 vendim i përket kërkesës së paraqitur nga Këshilli i Ministrave.

Vendimet moskalimi të grupuara sipas subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese



❖ Vendime moskalimi të marra gjatë vitit 2024 të grupuara sipas objektit të kërkesës:


- ✚ 12 vendime u përkasin kërkesave me objekt *papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*;
- ✚ 2 vendime u përkasin kërkesave me objekt *papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën së bashku me vendime të Këshillit të Ministrave*;
- ✚ 3 vendime u përkasin kërkesave me objekt *kundërshtimin e akteve të pushtetit publik*;
- ✚ 5 vendime u përkasin kërkesave me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të sistemit të zakonshëm në kuadër të procesit të rregullt së bashku papajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën*;
- ✚ 258 vendime u përkasin kërkesave me objekt *kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në kuadër të procesit të rregull ligjor*;
- ✚ 9 vendime u përkasin kërkesave me objekt *konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 17 vendime u përkasin kërkesave me objekt *shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të sistemit të zakonshëm në kuadër të procesit të rregullt së bashku me konstatimin e cenimit të së drejtës si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm*;
- ✚ 16 vendime u përkasin kërkesave me objekt *interpretimin/korrigjimin/saktësimin/rishikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*.



❖ Vendime moskalimi të marra gjatë vitit 2024 nga kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve:

- ✚ 275 vendime janë marrë nga Kolegjet e Gjykatës Kushtetuese;
- ✚ 47 janë marrë nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Vendime moskalimi të marra nga kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve



Aktualisht (datë 06.01.2024) numri total i kërkesave që presin të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese është **104**, nga të cilat:

- ✚ 28 kërkesa janë në shqyrtim në seancë plenare;
- ✚ 5 kërkesa janë në shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
- ✚ 71 kërkesa janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga kolegjet e Gjykatës Kushtetuese.

Janar 2025

**Përgatiti:**

**Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit**